



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## KOMITETI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

NGA: KPUMA

PËR: KUVENDIN KOMUNAL GJILAN

Kryesues Z.Kushtrim Kadriu  
Përmes: Sekretaris së Kuvendit  
Z.Sadri Arifi

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Janar 2025



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal z.Kadriu,

Të nderuar Asambleistë të Kuvendit Komunal,

Me anë të këtij raporti , Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit i përbere nga Antarët: Imran Haziri, Laurent Shabani, Leutrim Bllaca, Nafije Kadriu, Omer Daku , dëshiron të njoftoje Kuvendin Komunal për ecurin e Komitetit gjatë vitit të kaluar .

**Më 21.03.2024 në mbledhjen e I të Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit u mbajt mbledhja ku në Rend të Punës kishim këto pika:**

- Lista e Vijimit dhe Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar
- Plani Lokal i Veprimit per Cilesi te Ajrit 2024/2028.
- Raporti i Drejtorise së DUPMM per vitin 2023.
- Ku ka arritur procesi ne lidhje me PZHK-ne, cilat aktivitet jane zhvilluar gjate ketyre 2 viteve per hapat dhe aktivitetet e realizuara.
- Te ndryshme

**Me 14.05.2024 në mbledhjen e II të Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit u mbajt mbledhja ku në Rend të Punës kishim këto pika:**

1. Lista e vijimit dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024/2028
3. Ku ka arritur procesi në lidhje me PZHK-në, cilat aktivitete janë zhvilluar gjatë këtyre 2 viteve për hapat dhe aktivitetet e realizuara
4. Rregullore mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës
5. Kategoria e I tarifa 2024



6. Propozim për taksat administrative për leje ndërtimore, leje për rrënim dhe tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

7. Taksa administrative për leje ndërtimore 2024

8. Taksa administrative për leje rrënimi 2024

9. Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës për vitin 2024

10. Njoftim për diskutim publik

11. Shkresë përcjellëse nga Komuna e Gjilanit

12. Kërkesë nga Këshilli i fshatit Goden

13. Të ndryshme

**Me 23.07.2024 në mbledhjen e III të Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit u mbajt mbledhja ku në Rend të Punës kishim këto pika:**

Lista e vijimit dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

2. Shqyrtimi i shkresës nga Komuna e Gjilanit me numër të protokollit 7054-

2/23 të datës 04.06.2024 për dhënien e pëlqimit për Taksat e lejes

Ndërtimore.

3. Kërkesë nga Këshilli i fshatit Goden

4. Kërkesë nga Këshilli i fshatit Bresalc

5. Të ndryshme

**Me 23.09.2024 në mbledhjen e III të Komitetit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit u mbajt mbledhja ku në Rend të Punës kishim këto pika:**

1. Lista e vijimit

2. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme nga grupet e interesave

3. Të ndryshme



Të nderuar asambleistë,

Dëshirojmë t'ju njoftojmë se, në periudhën e vitit 2024, Komiteti ynë ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi Komunal pikat e mëposhtme:

1. **Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024/2028** – Rekomandimi për miratimin e Planit të veprimit që synon përmirësimin e cilësisë së ajrit në nivel lokal, përmes masave konkrete dhe angazhimeve afatgjata.
2. **Kërkesë nga Këshilli i Fshatit Goden** – Kërkesa për identifikimin dhe mbrojtjen e një pjese të varrezave që, sipas fakteve historike një pjesë e tyre janë të vendosura në fshatin Vrapqiq. Kjo kërkesë ka si qëllim ruajtjen e këtij vendi të rëndësishëm kulturor dhe historik për banorët e kësaj pjese.
3. **Kërkesë nga Këshilli i Fshatit Bresalc** – Kërkesa për ndarjen e parcelës ku ndodhet monumenti **Guri i Agushit**, me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e këtij monumenti historik dhe kulturor, i cili ka vlerë të madhe për komunitetin e fshatit Bresalc.
4. **Kërkesë nga Këshilli i Fshatit Zheger** – Kërkesa për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e memorialit me rastin e shënimit të 25-vjetorit të rënëve të fshatit Zheger. Ky memorial do të jetë një kujtim i shenjtë i sakrificave të atyre që dhanë jetën për fshatin dhe komunitetin.

Dëshirojmë t'ju njoftojmë se, në vitin 2025, Komiteti ynë ka planifikuar të mbajë **9 takime**. Objektivat për vitin 2025 janë të detajuara në planin që mund ta gjeni të bashkangjitur te Sekretaria e Kuvendit.

Takimet do të mbahen në përputhje me planin dhe do të trajtohen çështje të rëndësishme për zhvillimin e komunitetit dhe avancimin e projekteve të miratuara.

Kryesues i Komitetit:

Imran Haziri

Janar 2025